



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2054/3 Prot.

Tiranë, më 27.11.2025

VENDIM

Nr. 1, datë 27.11.2025

PËR
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER I ARTEVE NË “MUZIKË JAZZ DHE MËSUESI”, PRANË
DEPARTAMENTIT TË INTERPRETIMIT, NË FAKULTETIN E MUZIKËS, TË
UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Mbështetur në nenin 3, pikat 1 dhe 2, në nenin 35, në nenin 49, si dhe në nenin 75 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Kreun IV, seksioni A, të Udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 48 të Statutit të Universitetit të Arteve, pasi shqyrtoi shkresën nr. 2054/2 prot., datë 26.11.2025, nëpërmjet së cilës përcillet Vendimi i Senatit Akademik të UART nr. 59, datë 26.11.2025 “Për miratimin paraprak të hapjes së programit të studimit “Muzikë Jazz dhe Mësuesi”, në Fakultetin e Muzikës, të Universitetit të Arteve”, pasi e diskutoi, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në “Muzikë Jazz dhe Mësuesi”, pranë Departamentit të Interpretimit, në Fakultetin e Muzikës, të Universitetit të Arteve.
2. Ky vendim t’i dërgohet për miratim Ministrisë së Arsimit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Interpretimit, të Fakultetit të Muzikës, të Universitetit të Arteve.
4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



BORDI I ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik Bisha

Anisa Pollo




(Kryetar)

(Anëtar)

Etjola Kola

Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi

(Anëtar)



(Anëtar)

Oltjon Muzaka


Lorenc Vangjeli

(Anëtar)



(Anëtar)

Vladimir Llakaj



(Anëtar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI**

Nr. 2086/2 Prot.

Tiranë, më 26.11.2025

Lënda: Përcillet për miratim VSA nr. 59, datë 26.11.2025

BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UART

Për dijeni: ADMINISTRATORIT TË UART
Znj. Alma Sinanaj

Të nderuar,

Bazuar në nenin 35 si dhe në nenin 37, pika 2 të ligjit nr 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, bashkëngjitur dërgohet për miratim hapja e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Arteve në “Muzikë Jazz dhe Mësuesi”, miratuar paraprakisht me Vendimin e Senatit Akademik nr. 59, datë 26.11.2025 “Për miratimin paraprak të hapjes së programit të studimit “Muzikë Jazz dhe Mësuesi”, në Fakultetin e Muzikës, të Universitetit të Arteve”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSREKTORI

Prof. Asoc. Dorian Çene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 204/1 Prot.

Tiranë, më 26.11.2025

VENDIM

Nr. 58, datë 26.11.2025

PËR
MIRATIMIN PARAPRAK TË HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "MUZIKË
JAZZ DHE MËSUESI", NË FAKULTETIN E MUZIKËS, TË UNIVERSITETIT TË
ARTEVE

Mbështetur në nenin 3, pikat 1 dhe 2, në nenin 38, pika 1, germa "dh", në nenin 57, pika 2 si dhe në nenin 75 të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në Kreun IV, seksioni A, të Udhëzimit nr. 1, datë 14.1.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë*", i ndryshuar, në nenin 24, pika 1, germa "i" të Statutit të Universitetit të Arteve, pasi shqyrtoi shkresën nr. 2054 prot., datë 19.11.2025 të Fakultetit të Muzikës, nëpërmjet së cilës përcillet kërkesa e Departamentit të Interpretimit, për hapjen e programit "Muzikë Jazz dhe Mësuesi" në ciklin e dytë të studimeve, Senati Akademik i UART, pasi e diskutoi, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin paraparak të hapjes së programit të studimit "Muzikë Jazz dhe Mësuesi", në Fakultetin e Muzikës, të Universitetit të Arteve.
2. Ky vendim t'i dërgohet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve dhe për njohje Fakultetit të Muzikës dhe Sektorit Mësimor, të Kurrikulës, Informimit të Studentëve dhe ALUMNI.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA

Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion SHIMA

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRIË,
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKAN

*Kër vendim Senatit
Akademit. Të bashkëpunojë
procedurën sipas aktit
ligjor dhe nënligjor të
shqiptarëve*

Nr. 2054 Prot.

Tiranë, më 19.11.2025

Lënda: Shkresë përcjellëse e kërkesës së Departamentit të Interpretimit, për hapjen e programit "Muzikë Jazz dhe Mësuesi" në ciklin e dytë të studimeve.

REKTORIT

Prof. Dr. Erald Bakalli

I nderuar Z. Rektor,

Ju përcjell kërkesën e Departamentit të Interpretimit për hapjen e programit "Jazz dhe Mësuesi" në ciklin e dytë të studimeve.

Me respekt,

DEKANI

Prof. Arben LLOZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKAN

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2025

Lënda: Kërkesë së Departamentit të Interpretimit, për hapjen e programit " Muzikë Jazz dhe Mësuesi" në ciklin e dytë të studimeve .

Dekanit të Fakultetit të Muzikës,

Prof. Arben Llozi

I nderuar Z. Dekan

Ashtu siç jeni në dijeni, programi i studimit Bsc në Muzikë Jazz, i cili ka përfunduar edhe procesin e akreditimit, që nga viti i ofrimit të tij pranë Departamentit të Interpretimit, ka një kërkesë në rritje për të vazhduar studimet edhe në ciklin e dytë Master dhe Mësuesi.

Këta studentë kanë nevojë të mundësojnë zgjerimin dhe zotërimin e kompetencave profesionale, artistike dhe pedagogjike.

Nisur nga kjo kërkesë, si dhe nga risia e ofrimit të një programi të tillë, lind e domosdoshme hapja e programit të ciklit të dytë, me të njejtin emërtim, por me profile ku studenti ndihmohet në avancimin profesional në disiplinën e përzgjedhur, konkretisht bëhet fjalë për mundësinë e hapjes së programit të studimit Master i Arteve në Muzikë Jazz dhe Mësuesi me profile: Piano Jazz; Saksofon Jazz; Bateri dhe Perkusion Jazz; Bas Elektrik Jazz dhe Kontrabas Jazz.

Lutem, bëni të mundur përcjelljen e kësaj kërkesë pranë Rektoratit të UART, në mënyrë që të vazhdohet me përgatitjen e procedurës së aplikimit të këtij programi sipas Legjislacionit në fuqi.

Me respekt

Prof. Asoc. Elvis Rudi

Përgjegjës i Departamentit të Interpretimit